



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR
GENERAL

Nr. Dok:2113.2-2008-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR RAPORTET FINANCIARE DHE
MENAXHIMIT TË PASURISË SË KOMPLEKSIT TREPÇA-
MINIERA E STAN TËRGUT PËR PERIUDHEN JANAR –
QERSHOR 2008**

Prishtinë, Nëntor 2008

TABELA E PËRMBAJTJES

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Fushëveprimi i auditimit
- IV. Opinioni i auditimit
- V. Qasja e auditimit
- VI. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit
 - 1. Raportet financiare
 - 2. Sistemi i kontrollit të brendshëm
 - 3. Të Hyrat
 - 4. Pagat dhe mëditjet
 - 5. Pensionet parakohshme
 - 6. Stipendionet
 - 7. Prokurimi
 - 8. Menaxhimi i Pasurisë
 - 9. Menaxhimi i automjeteve

Lista e shkurtesave

AP	Auditori Përgjithshëm
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
LPFMA	Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZAP	Zyra e Auditorit Përgjithshëm
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Zyra e Auditorit Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Raporteve financiare dhe Menaxhimin pasurisë se Kompleksit Trepçë, me theks të veçantë Miniera e Stan Tërg.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe përfshinë testimet dhe procedurat e tilla që ne i kemi konsideruar të nevojshme për të dhënë një konkluzioni lidhur me raportet financiare, dhe menaxhimin e pasurisë.

Gjate auditimit ne kompleksin Trepça – Stan Tërg , ZAP ka vërejtur dobësi ne funksionimin e sistemit te kontrollit te brendshëm. Dobësitë vërehen sidomos në fushën e prokurimit, raporte financiare dhe menaxhimin e pasurisë.

Për mendimin tonë Raportet financiare nuk paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozitës financiare të Kompleksit Trepça - Stan Tërg prej 01.01.2008 deri më 30 Qershor 2008 dhe rezultatet e aktiviteteve të saja për vitin në fjalë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Gjate auditimit në nuk kemi mund te sigurojmë të dhëna për pjesën e cila i përket pjesës veriore te Trepçës, prandaj edhe raportet si dhe pasqyrat financiare janë të përgjysmuara.

Auditimi ynë ka identifikuar mangësi serioze ne:

- Ne kontrollin e brendshëm
- Ne angazhimin për të vendosur një sistem të mire te kontabilitetit,dhe raporteve financiare.
- Ne respektimin e procedurave te prokurimit
- Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Në tërësi auditimi ka rezultuar me gjithsej 13 rekomandime kryesore, të cilat duhet të adresohen menjëherë nga menaxhmenti sa u përket:

- Raportet financiare,
- Sistemi i kontrollit te brendshëm,
- Të hyrave,
- Pagat dhe mëditjet,
- Pensione të Parakohshme, dhe stipendioneve
- Menaxhimit te pasurive,
- Menaxhimi i automjeteve

Ne rekomandojmë që menaxhmenti te ndërmarre masa për përmirësimin e nivelit të tanishëm të kontrollit të brendshëm në kuadër të organizatës.

Shembujt e ndryshëm të kontrollit të dobët të brendshëm në gjithë organizatën që janë theksuar

në të gjeturat dhe rekomandimet tona bëjnë të konkludojmë që në tërësi niveli i kontrollit financiar është joadekuat dhe duhet medoemos të përmirësohet.

II. HYRJE

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAP) është themeluar me Ligjin nr. 03/L-075 të Kuvendit të Kosovës, si institucion i pavarur i përhershëm i themeluar si pjesë e kornizës demokratike të Kosovës. ZAP udhëhiqet nga Auditori i përgjithshëm dhe i raporton Kuvendit të Kosovës. Mandati i auditimit të ZAP-së është cekur në paragrafin 3.2 të Ligjit nr. 03/L-075, i cili përfshin edhe institucionin tuaj, pasi që ai financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Auditimi i buxhetit bëhet duke u bazuar në ligjet sistemore në fushën financiare si:

“Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” nr. 03/L-048 i shpallur nga Kuvendi i Kosovës.“Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë” nr. 2003/17 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/3 si dhe në aktet tjera relevante ligjore dhe përfshinë:

- nëse raportet financiare japin një gjendje të vërtetë dhe të drejtë;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- përkatësinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të zbatuara në kuadër të institucionit ose të entitetit që iu është nënshtruar auditimit; si dhe
- të gjitha çështjet të cilat dalin ose kanë të bëjnë me auditimin;

III. FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

ZAP ka bërë auditimin e raporteve financiare të Trepçës-Stan Tërg për periudhën 01.01.2008 deri 30.06.2008.

Objektivi primar i këtij auditimi ishte që t'i mundësohet ZAP-it të shprehë konkluzion nëse Raportet financiare të Trepçës-Stan Tërg, japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë të të hyrave, shpenzimeve si dhe menaxhimin e pasurisë për periudhën janar-qershor të vitit 2008 në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit .

SNKSP-të nxirren nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (BSNA) i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK). Saktësia dhe plotësia e Raporteve financiare si dhe shkresave shoqëruese , janë përgjegjësi e menaxhmentit të Minierës së Trepçe –Stan Tërg .

IV. KONKLUZION I AUDITIMIT

Per shkak te rendesis se qeshtjeve te theksuara ne pjesen hyrese te ketij raporti dhe ndjeshmerise se tyre ne pajtim me kerkesat dhe me nivelin e kerkuar te raportimit financiar dhe menaxhimit te asetëve , japim kete konkluzion te auditimit:

- Kompleksi Trepça- Miniera Stan Tërg nuk vepron në pajtueshmëri të plotë me Ligjin dhe Rregulloret e aplikueshme;
- Ne kemi vërejtur se entiteti nuk ka një sistem informativ adekuat kontabël, gjithashtu menaxhmenti nuk ka hartuar politika te kontabilitetit ne baze te te cilave do te ngrihej ky sistem;
- Çështjet rreth prokurimeve , sidomos ato qe kane te bëjnë me dosjet e tenderit, specifikacionit teknik dhe furnizimet jashtë kontratës,
- Kontrollat e brendshme janë aktualisht të paafta për të identifikuar dhe minimizuar dobësitë që mund të rezultojnë në mbarëvajtjen e aktiviteteve sidomos ato te komunikimit ne mes njësish punuese te Stan Tërg-ut dhe Departamentit te Financave ne kompleksin e Trepçës. Këto dobësi përfshijnë gjithashtu edhe menagjimin dhe mbikëqyrjen e dobët te pasurisë dhe përdorimit te tyre, si dhe
- Mungojnë procedurat e rregullta te rekrutimit, dosjet nuk janë complete si dhe mungojnë dëshmitë për kualifikimet e te punësuarve.

Kompleksi Trepça- Miniera Stan Tërg në të ardhmën duhet të bëjë përmirësimet e duhura, siç janë thënë përmes rekomandimeve të këtij raporti.

V. QASJA E AUDITIMIT

Auditimi ynë i raporteve financiare të Minierës se Trepçës – Stan Tërg për periudhën Janar-Qershor te vitit 2008 është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të hartuara nga Bordi Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë. Bordi funksionon si një organ përcaktues për standardet ndërkombëtare, nën patronazhin e FNK-së. SNA-të vendosin kornizën ndërkombëtare në kuadër së cilës ZAP kryen aktivitetin e saj dhe mbulon çështje si parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlerësimi i rreziqeve dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlerësuara, dëshmia e auditimit, mbështetja në punën e të tjerëve si dhe konkluzionet dhe raportimi mbi auditimin.

Auditimi ynë është planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës prej 13/10/2008 deri me 30/10/2008. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona, ne:

- Kemi rishikuar raportet financiare të Minierës se Trepçës-Stan Tërg në raport me dokumentet burimore qe e mbështesin këto raporte për periudhën gjashte mujore të vitit 2008;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;

- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin dhe informatat e tjera të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit. Ka të ngjarë që informata shtesë mund të kenë ekzistuar, të cilat nuk na janë siguruar, e të cilat po të na siguroheshin do të kishin mundur të ndryshonin të gjeturat tona të auditimit.

VI. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET KRYESORE TË AUDITIMIT

Auditimi ynë është fokusuar në rishikimin e raporteve financiare dhe në kryerjen e testeve substanciale për të konfirmuar saktësinë dhe validitetin e transaksioneve financiare. Krahas këtyre, kemi testuar menaxhimin e pasurisë si dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme të sistemeve dhe proceseve kryesore.

Menaxhmenti duhet të garantojë ekzistimin e aktiviteteve të kontrollit dhe që ato të kryhen rreth proceseve që janë nën kontrollin e tyre. Ata janë përgjegjës për aplikimin e kontrolleve të mjaftueshme për të siguruar që rreziqet të minimizohen në nivel të pranueshëm. Për mendimin tonë ekziston kontrollim i dobët sa i përket shpërndarjes së subvencioneve të dhëna nga buxheti i Kosovës si dhe menaxhim i pasurisë .

Të gjeturat kryesore janë grupuar sipas klasifikimit të shpenzimeve, po ashtu janë dhënë shembuj për të konfirmuar konkluzionet dhe rekomandimet tona. Kemi theksuar shembuj të ndryshëm të kontrollit të brendshëm të dobët në secilën pjesë të gjeturave duke dhënë po ashtu rekomandime për përmirësimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim paraqesim të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit që kanë rezultuar nga auditimi ynë i raporteve financiare dhe menaxhimit të pasurisë.

1. RAPORTET FINANCIARE

Raportet Financiare (RF) duhet të përgatiten nga secili entitet i pavarur, bazuar në regjistrat e vet kontabël dhe asisoj që të paraqesin përgjegjshmëri dhe transparencë në prezantimin e të dhënave . Format i tyre kërkon shpalosje dhe shpjegime shtesë në formë të Shënimeve, që siguron informacion për lexuesit.

Gjate auditimit tone ne nuk kemi mundur te sigurojmë raportet financiare, si dhe raportet për mjetet e shfrytëzuara nga buxheti i Kosovës për subvencione operative dhe kapitale për pjesën veriore të Trepçës.

Këto Raportet financiare duhet të përgatiten duke u bazuar në regjistrat kontabël që duhet të mbahen për çdo organizatë publike.

- Të hyrat e Kompleksit Trepça –Stan-Tërg ;

OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL • Rr. Gazmend Zaimi # 59, PRISTINË 10 000

PHONE: +381 (0) 38 2535 162/244/119 • FAX: +381 (0) 38 2535 122

- Shpenzimet reale të bëra.
- Detyrimet e papaguara të Kompleksit Trepça-Stan-Tërg ;
- Pasuritë (asetet) Kompleksit Trepça-Stan-Tërg ;
- Përvetësimet;
- Ndryshimet e përvetësimeve;
- Përvetësimet që janë vënë në dispozicion të Kompleksit Trepça-Stan-Tërg për shpenzime përmes njoftimeve për fondet e alokuara;

Pasqyrat Financiare duhet të përgatiten në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

E gjetura

Gjate auditimit të raporteve financiare në Kompleksin Trepça kemi vërejtur se entiteti nuk ka një sistem informativ adekuat kontabël, nuk ka hartuar politika të kontabilitetit si dhe i mungojnë shpalosjet për pasqyrat financiare.

Konkluzion

Mungesa e politikave kontabël, si dhe shpalosjeve në pasqyra financiare ndikon që raportet dhe pasqyrat financiare të jene të mangëta sa përket prezantimit të drejte dhe të sakte.

Rekomandim 1

- Rekomandojmë menaxhmentin e entitetit të hartoj politika kontabël, si dhe që të përgatite pasqyrat financiare në pajtim me standardet kosovare si dhe ndërkombëtare të kontabilitetit.
- Rekomandojmë Entitetin që gjate hartimit të pasqyrave financiare të përfshihen edhe raportet nga pjesa veriore, në mënyrë që të kemi një prezantim të drejte dhe të sakte për pasqyrat financiare të kompleksit Trepça Stan Tërg.

Komenti i Kompleksit Trepça

Lidhur me gjetjen e cekur në draft mbi mospasjen e “në sistemi informative adekuat kontabël dhe se nuk ka politika të kontabilitetit...”

Trepça si entitet biznesi është i regjistruar nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si një entitet i cili përbëhet nga Minierat dhe kapacitetet tjera të saja në pjesën Jugore dhe qendrore si dhe Minierat dhe kapacitetet tjera që gjenden në pjesën Veriore të qytetit të Mitrovicës respektivisht Kosovës. Në këtë kuptim Trepça vetëm juridikisht është një entitet por praktikisht ajo është e ndare në dysh sikurse edhe qyteti i Mitrovicës. Andaj çdo tentim i krijimit të një sistemi unik informative kontabël deri me tani ka qene i pamundur. Kjo gjë është ashpërsuar edhe më tepër pas 17.Shkurtit kur menaxhmenti i pjesës Veriore të Trepçës pothuajse ka ndërprerë kontaktet me menaxhmentin e pjesës Jugore dhe edhe me AKM-në respektivisht AKP-në si pasardhëse të AKM-së. Në mungesë të një sistemi softuerik kontabël i cili është tentuar që të sigurohet por pa sukses për shkak të ofertave të papërbalueshme në çmim nga ana

e Trepçës - Jug dhe mungesës se vullnetit të pjesës Veriore të Trepçës që të participojnë në financimin dhe përdorimin e këtij sistemi informativ kompjuterik, është krijuar një sistem kontabël i bazuar në fletë të Excel-it në mënyrë që të sigurohen të dhëna të mjaftueshme për përpilimin e raporteve financiare se pakut për pjesën Jugore të Trepçës. Në këtë drejtim janë përgatitë raporte interne të ndara financiare veç e veç për secilën pjesë përbërëse të Trepçës-Jug gjegjësisht për njësitë e saja. Tek e fundit është përgjegjësi e Trepçës të përpilojë pasqyra financiare për Trepçën si tersi si entitet biznesi jo për njësitë e saja.

Vlerësimi i Auditorit

Gjatë auditimit në Kompleksi Trepça nuk kemi hasur në politika kontabël të aprovuara nga Menaxhmenti, sistemi dhe evidenca kontabël është ndërtuar dhe bazuar në fletë të Excel-it që nuk ofrojnë siguri që të dhënat kontabël janë përpunuar në mënyrë të drejtë dhe janë të mjaftueshme, si dhe pasqyrat financiare për vitin 2007 nuk janë ndërtuar në bazë të standardeve Kosovare të kontabilitetit.

Komenti e juaj nuk paraqet arsye bindëse për të ndryshuar të gjeturën.

2. SISTEMI I KONTROLLIT TE BRENDSHEM

Dokumenti i politikave qeveritare përcakton Objektivat kryesore të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) e që janë për të siguruar:

- Besueshmëri dhe integritet të informatave,;
- Përputhje me politika, plane, procedura, ligje, rregullore dhe standarde;
- Ruajtje të pasurive;
- Shfrytëzim ekonomik, efikas dhe të efektshëm të burimeve

Praktika e mirë e qeverisjes kërkon që aktiviteti i saj të kushtojë rendësi:

- Vlerësimi të besueshmërisë, përshtatshmërisë dhe efikasitetit të llogarimbajtjes, kontrolleve operative dhe administrative.
- Sigurimit që kontrollet e brendshme rezultojnë në regjistrimin e menjëhershëm dhe të saktë të transaksioneve dhe ruajtjen e duhur të aseteve.
- Konstatimit nëse Kompleksi Trepça- Stan Tërg vepron në pajtim me ligjet dhe rregulloret dhe nëse u përmbahet politikave.
- Konstatimit nëse menaxhmenti është duke ndërmarrë hapat e duhur për adresimin e mangësive të tanishme dhe të mëhershme të kontrollit dhe rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit.

Të gjeturat

Gjatë auditimit në Minierën e Trepçës - Stan Tërg kemi konstatuar se nuk ekziston një kontroll i mirë i brendshëm sa i përket komunikimit në mes njësisë punuese të Stan Tërg-ut dhe

Departamentit të Financave në kompleksin e Trepçës. Kjo vërehet sidomos në mos harmonizimin e të hyrave në mes të departamentit të financave dhe njësisë Stan Tërg. Po ashtu ende reflektojnë dobësi në menaxhimin e shpenzimeve të cilat janë realizuar përmes procedurave të prokurimit, dobësi në menaxhimin e pasurisë, shfrytëzimin e automjeteve, dhënies së stipendioneve, stimulimeve, shtesave, si dhe dosje të pakompletuara të personelit.

Konkluzioni

Mos harmonizimi i raporteve në mes të njësive përkatëse dhe departamentit të financa ndikon në prezantimin e të dhënave jo të sakta të raporteve dhe pasqyrave financiare

Rekomandimi 2

Rekomandojmë entitetin që të përmirësojë nivelin e kontrollit të brendshëm sa i përket komunikimit në mes të njësive punuese dhe që të bëjë harmonizimet e raporteve mes departamenteve përkatëse dhe departamentit për buxhet dhe financa.

3. TE HYRAT VETJAKE

Te hyrat vetjake të Minierës së Stan Tërg për periudhën janar-qershor janë 942,171 €.

Kompleksi Trepça- Miniera e Stan Tërgut të hyrat primare i siguron nga realizimi i produkteve të gatshme të koncentratit të Zinkut dhe Plumbit.

Te hyrat tjera sigurohen nga lëshimi i objekteve me qira, nga terminali doganor, te hyrat tjera (te hyrat nga mbeturinat) dhe të hyrat nga BKK .

Shuma totale e pranimeve për gjashtëmuorin e parë të vitit 2008 ishte 5,434,364 €, prej tyre 2,465,150 € janë nga te hyrat vetjake të kompleksit, ndërsa pjesa tjetër prej 2,969,214 janë te hyrat prej BKK- se.

Gjate auditimit në nuk kemi mund të sigurojmë të dhënat sa i përket të hyrave në pjesën e cila gjendet në pjesën veriore të Trepçës.

Tabela nr.1

Te hyrat nga shitja e koncentratit të plumbit	1,708,392
Te hyrat nga shitja e koncentratit të Zinkut	306,256
Te hyrat nga sulfati i aluminit	81,171
Te hyrat tjera	38,904
Te hyrat nga terminali Doganor	191,314
Te hyrat nga qiraja	53,031
Te hyrat nga shitja e rimorkiove	13,651
Te hyrat nga shitja mbeturinave	68,957
Te hyrat nga dokumentet tenderues	3,474
Te hyrat nga BKK-Subvencione operative ¹	1,905,403
Te hyrat nga BKK-Subvencione kapitale	1,063,811

¹ Subvencionet operative janë rrogat, stipendionet si dhe pensionet të parakohshme

4. PAGAT DHE MËDITJET

Shpenzimet e pagave dhe mëditjeve për gjashtëmuorin e parë të vitit 2008 ishin 2,138,809 € për kompleksin Trepça Stan Tërg, prej tyre 102,274 kanë qene stimulime dhe shtesa. Numri mesatar i të punësuarve për këtë periudhë ka qene 1.370 të punësuar. Shpenzimet e pagave vetëm për minierën e Stan Tërg-ut kanë qene 1,127,418 €, prej tyre 81,294 € ishin për stimulime dhe shtesa tjera. Numri mesatar i të punësuarve në minierën e Stan Tërg-ut ka qene 598 me një mesatare të pagës prej 314 €.

Te Gjeturat

- Stimulimet si dhe shtesat tjera për punëtorët në njësinë punuese në Stan Tërg janë bërë pa kritere të caktuara
- Gjate ekzaminimit dosjeve të personelit kemi vërejtur se mungojnë procedurat e rregullta të rekrutimit, dosjet nuk janë komplete si dhe mungojnë dëshmitë për kualifikimet e të punësuarve.

Konkluzion

- Stimulimet dhe shtesat tjera pa kritere të përcaktuar ndikojnë në shfrytëzimin e mjeteve në mënyrë jo racionale si dhe ndikojnë në destimulimin e punëtorëve në kuadër të entitetit.
- Dosjet e pa kompletuar janë shkelje të dispozitave ligjore si dhe paraqesin jo transparence.

Rekomandim 3

- Rekomandojmë entitetin që të hartoj politika të qarta si dhe të përcaktoj kriter me rastin e nxitjes apo stimulimit të punëtorëve për arritjen e objektivëve të caktuara.
- Rekomandojmë entitetin që të zbatoj të gjitha procedurat e rekrutimit, kompletimin dosjeve të personelit. Respektivisht të zbatoj Udhëzimin Administrativ nr. MSHP / DASHC 2003/11 Procedurat e Dosjeve të Personelit për zbatimin e Urdhërësës Administrative nr. 2003/2 – zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës.

5. PENSIONET E PARAKOHSHME

Pensionet e parakohshme që u bëhen ish punëtorëve të Kompleksit Trepça janë në vlerë prej 80€ për çdo të punësuar, prej tyre 50€ nga MPMS, e pjesa tjetër prej 30€ nga Kompleksi Trepça e cila behet në bazë të vendimit administrativ të datës 23.06.2004. Shuma e përgjithshme e pensioneve të parakohshme për punëtorët e kompleksit Trepça për periudhë janar - qershor

OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL • Rr. Gazmend Zaimi # 59, PRISTINË 10 000

PHONE: +381 (0) 38 2535 162/244/119 • FAX: +381 (0) 38 2535 122

është 274,630 ndërsa numri i shfrytëzuesve të pensioneve të parakohshme ishte për 1.516 pensionist.

Nga shuma e përgjithshme e pensioneve të parakohshme vetëm për njësinë e Stan Tërg-ut kemi vlerën 134,610 si dhe numrin e shfrytëzuesve të pensioneve 743 pensionist. Pensionet janë dhëne ne baze të udhëzimit administrative administrativ nr. 02/2006 për pensionimet e parakohshme për punëtorët e kompleksit „Trepça,, nën administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore në Kosovë.

Ne baze të nenit 2 të këtij Udhëzimi përcaktohen kushtet dhe kriteret për shfrytëzimin e pensionit të parakohshëm. Kriteret baze janë:

1. Të jete të moshës 50-65 vjeçar.
2. Punëtorët e punësuar në minierë tek të cilët paraqitet pa aftësia për punë.
3. Të ketë 10 vjet apo me shumë vite përvoja pune në Kompleksin Trepça
4. Të jete banor i përhershëm i Kosovës.
5. Të mos jete përfitues të asnjë skeme tjetër të financuar BKK.
6. Të mos realizoj të ardhura tjera nga punësimi i rregullt në Kosovë dhe jashtë Kosovës
7. Të ketë shkëputje të kontratës së punës në Kompleksin Trepça, si dhe minierat tjera si dhe heqja dore nga beneficionet tjera.
8. Personalisht duhet të beje tërheqjen e pensionit të parakohshme nga kontoja e Bankës.
9. Të argumentojnë aftin e kufizuar të punës më prezantimin e vlerësimit nga Komisioni mjekësor i departamentit të administratës pensionale të Kosovës që vepron në kuadër të MPMS.

E gjetura

Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit të pensioneve të parakohshëm kemi hasur në persona të cilët i shfrytëzojnë pensione të parakohshme prej 30 euro nga Kompleksin Trepça si dhe 50 euro nga MPMS dhe njëherit janë të punësuar në institucionet e tjera publike.

Konkluzion

Anashkalimi i kriterëve të përcaktuar për pensionet e parakohshme ndikon në mosrespektimin e kriterëve si dhe dëmtimin e buxhetit të kompleksit Trepça si dhe buxhetin shtetëror.

Rekomandim 4

Rekomandojmë entitetin që të hartoj politika me të forta të kontrollit të brendshëm të cilat do të ndikojnë në parandalimin e përfituesve të pensioneve të parakohshëm si dhe stipendioneve për ata persona që janë të punësuar në sektorin publik si dhe privat, respektivisht duhet të përmbahen UA 02/2006 për pensionimet e parakohshme për punëtorët e kompleksit „Trepça,, .

Komenti i Kompleksit Trepça

Në draft raport, në pikën 5 Pensionet e parakohshme në lidhje me gjetjen se gjatë ekzaminimit të dokumentacionit të pensioneve të parakohshme është hasur në persona të cilët i shfrytëzojnë pensionet e parakohshme nga Kompleksi Trepça në lartësi prej 30 € dhe nga ana e MPMS në lartësi prej 50€ dhe se njëherit janë të punësuar në sektorin publik me ç’rast dëmtohet buxheti i Kosovës,

Në pikën 6 të draft raportit të cekur të auditimit, auditorët kanë gjetur se punëtorët e moshës më të re se 50 vjeçare e të cilët gëzojnë të drejtën në stipendion për këtë nuk kanë hasë në akt sipas

të cilit bëhet pagesa e stipendioneve,

Nga arsyet e cekura më lartë e në pikat e cekura më lartë në afatin e paraparë epet sqarimi me sa vijon:

Pensionet e parakohshme të punëtorëve të Trepçës përkatësisht të minierave me mihje nëntokësore paguhen në bazë të Udhëzimit administrative të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale nr. 02/2006 të muajit Mars të vitit 2006, sipas nenit 2 al.1 pika 1 të këtij udhëzimi administrativ janë paraparë kushtet dhe mënyra e fitimit të pensionit të parakohshëm.

Alineja 6 e nenit 2 të Udhëzimit administrative parasheh se në mes kushteve tjera për fitimin e pensionit të parakohshëm është edhe kushti se aplikuesi nuk realizon të ardhura të tjera nga punësimi i rregullt në Kosovë apo jashtë saj, por edhe çfarëdo forme tjetër të vetëpunësimit.

Me rastin e aplikimit për pension të parakohshëm secili kandidat ka nënshkrua deklaratën me të cilën i njëjti hekë dorë nga pagesat tjera nga qeveria ose punëdhënësi për kohën sa realizon pensionin e parakohshëm. Trepça nuk ka mundësi dhe kompetencë për verifikimin e të ardhurave të tjera të shfrytëzuesit e pensioneve. MPMS me ndihmën e administratës tatimore ka zbulua afro 200 raste të pensionistëve që kanë të ardhura tjera, dhe Trepça menjëherë ata i ka largua prej listës. Herë pas here MPMS bën kontrolle ad-hoc dhe në të gjitha rastet Trepça reagon menjëherë.

Nga dispozita e cekur më lartë shihet qartë se përfituesit e pensionit të parakohshëm nuk mundë të gëzojnë këtë drejtë nëse janë të punësuar mirëpo menaxhmenti i Trepçës përkatësisht i njësjve organizative të saj nuk kanë mundësi që të hulumtojnë apo të zbulojnë rastet e përfituesve të pensionit të cilët janë të punësuar.

Pagesa e stipendioneve për ish punëtorët e Organizatave të Trepçës paguhen në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës të vitit 2005 e të cilin vendim Trepça nuk e ka marrë nga Qeveria e atëherëshme e Kosovës.

Vlerësimet e Auditorit

Kompleksi Trepça duhet të hartoj pulitka dhe procedura për largimin sa më të shpejtë të personave të cilët janë shfrytëzues të skemës pensionale si dhe punojnë në vende tjera të punës. Nuk ekzistojnë arsye bindëse për ndryshimin e të gjeturës

6. STIPENDIONET

Stipendionet janë pagese të cilat i u bëhen ish të punësuarve të Kompleksit Trepça nga 30€, për persona që janë nën moshën 50 vjeçare të afte për punë dhe që presin të fillojnë punën në Kompleksin Trepça. Shuma e përgjithshme e subvencioneve për periudhën janar-qershor është 159.440 € , prej tyre 92,310 € i takojnë pjesë jugore, e pjesa tjetër prej 67,130 pjesës veriore.

Numri i ish të punësuarve që kanë marrë stipendione në pjesën jugore gjatë kësaj periudhe ka qene në mesataren 500.

Ndërsa për pjesën veriore nuk kemi mundë të sigurojmë të dhëna sa i përket numrit të shfrytëzuesve të stipendioneve.

E Gjetura

Gjate ekzaminimit të lendeve për stipendione nuk kemi hasur në ndonjë udhëzim administrativ apo vendim të posaçme që përcakton formën dhe mënyrën e dhënies së stipendioneve.

Konkluzioni

Mungesa e vendimeve përkatëse, formave si dhe kritereve të përcaktuar për dhënien e stipendioneve do të ndikon në shfrytëzimin e buxhetit në mënyrë joracionale

Rekomandim 5

Rekomandojmë entitetin që të hartoj kritere si dhe rregullimin e procedurave dhe rregullave të qarta mbi mënyrën si dhe formën e dhënies së stipendioneve.

7. PROKURIMI

Ligji mbi Prokurimin Publik 2003/17 përcakton standardet që duhet të zbatohen gjatë përdorimit të parasë publike në aktivitetin e prokurimit. Parimet e përgjithshme të LPP-së presin të ketë çmim ekonomik, efektivitet, barazi dhe paanësi për të gjitha kontratat e prokurimit.

Shuma totale e shpenzimeve për mallra e shërbime dhe për investime kapitale për gjashtëmuorin e parë të vitit ka qenë 3,447,030 €. Nga kjo vlerë, 164,097 €, është financuar nga BKK. Nga shuma totale në kemi marrë si mostër 8 lende në vlerë prej 748,867 €.

Gjatë auditimit tonë në kemi vërejtur se në menaxhimin e prokurimit ende ekzistojnë disa pika të dobëta të cilat duhet të përmirësohen në të ardhmen. Pikat kryesore që kërkojnë të përmirësohen janë dosjet e tenderit, specifikacioni teknik dhe furnizimet jashtë kontratës.

Te gjeturat në menaxhimin e prokurimit

7.1. Planifikimi Prokurimit

Gjatë ekzaminimit të lendeve të caktuara kemi vërejtur se entiteti nuk posedon planin e prokurimit për vitin 2008.

Konkluzion

Mungesa e planit të prokurimit ndikon që entiteti të mos arrijë objektivat dhe strategji të caktuara nga entiteti.

Rekomandim 6

Rekomandojmë entitetin që në të ardhmen të hartoj planin e prokurimit se dhe që blerja e mallrave dhe shërbimeve të bëhet në pajtim me planin e prokurimit, respektivisht të veproj sipas nenit 8 të LPP-2003/17.

Komenti i Kompleksit Trepça

Planifikimi i prokurimit

Në kemi dorëzuar planet paraprake (preliminare) të prokurimit për vitin 2008 në Agjencionin e Prokurimit Publik (APP) më datë 12.11.2007-(në shtojcë vetëm kopja e faqes së parë ku shihet data e pranimit dhe vula e protokollit nga APP-ja) si dhe planet

përfundimtare (finale) për vitin 2008 të dorëzuara në APP me datën 06.03.2008 pasi që Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2008 është aprovuar disa ditë më heret (sipas nenit 7.2 të Ligjit për Prokurim Publik)-kopje ku shihet data e pranimit dhe vula e protokollit e APP-ës.

Vlerësimet e Auditorit

Gjate punës në teren nuk na është ofruar plani i prokurimit, mirëpo nga komentet e juaja na është dokumentuar se ekziston plani i prokurimit, prandaj komenti i juaj pranohet.

7.2. Zotimi i Mjeteve

Me rastin e ekzaminimit të këtyre lendeve kemi vërejtur se entiteti ka hyre në obligime me operatorët ekonomik pa zotimin e mjeteve. Mungesa e zotimit të mjeteve është vërejtur të kontratat:

- Furnizimi me pompë për Minierën me flotacion Trepça në Stan Tërg me numër identifikimi: ST-018/2008, në vlerë 97,678 €.
- Furnizimi me eksploziv për Minierën e Stan Tërg-Artan me numër identifikimi: ST+KHA-045/2008, në vlerë 71,000 €.
- Furnizimi me Makinë ngarkuese për Minierën nëntokësore (underground LHD) me numër identifikimi: ST-015/08 në vlerë 286,350 €.

Konkluzioni

Hyrja e entitetit në obligime pa zotimin e mjeteve përmban në vetë një rrezik se obligimet nuk mund të mbulohen në të ardhmen, mund të krijohen shpenzime të cilat nuk mund të mbulohen. Veprimet si të tilla konsiderohen si të paligjshme dhe të palejueshme.

Rekomandim 7

I rekomandojmë Komplexit Trepça që të përmbahet Nenit 8.2 të Ligjit të Prokurimit mbi disponueshmërinë e mjeteve.

Komenti i Komplexit Trepça

Zotimi i mjeteve. Nevojitet një sqarim në procedurën e ndarjes së buxhetit nga ana e ish AKM-ës për "Trepçën". AKM-ja është bartëse e kërkesës së buxhetit për të gjitha ndërmarrjet që janë nën administrim të saj, pra edhe të "Trepçës". Paraprakisht para se të dorëzohet kërkesa për buxhet në MEF, AKM-ja i konsolidon të gjitha kërkesat për buxhet nga ndërmarrjet që i ka nën administrim. Kështu edhe nga "Trepça" shkon kërkesa e specifikuar që më parë për programe të caktuara të cilat janë të specifikuara sipas projekteve.

Pas aprovimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës nga ana e Kuvendit të Kosovës alokimi i buxhetit i bëhet AKM-ës e pastaj AKM-ja të gjitha agjencioneve shpenzuese që janë në administrim të saj. Dmth se ne kemi filluar procedurat e prokurimit vetëm pas aprovimit të buxhetit por që ende nuk kanë mundur të bëhen zotimet deri sa AKM-ja të bën alokimin e

mjeteve buxhetore që ma tepër ka qenë procedurë administrative.

Me qenë se ne i kemi ditur projektet të cilat i kemi paraqitur me kërkesë në projektet e propozuara për buxhet dhe pasi kemi marrë njoftimin nga AKM-ja se është aprovuar buxheti ne kemi inicuar disa projekte që pastaj ofertimi ka treguar se kemi pasur të drejtë pasi ato dy projekte kanë kërkuar kohë më të gjatë të ofertimit dhe të realizimit (tenderi për furnizim me makinë ngarkuese për miniera nëntokësore (underground LHD)-vlerë e madhe, me ref:ST-015/08-vlera 286,350 € dhe furnizim me pompë për Minierën me Flotacion-“Trepça” në Stantërg me ref:ST-018/08- me vlerë 97,678 €, kurse tenderi për eksploziv edhe ashtu vetëm pjesërisht ka qenë i bazuar në financim nga BKK-ja kurse pjesa tjetër nga burimet vetjake. Me gjithë këtë për shkak të përfundimit të punës së AKM-ës është dashur prapë të bëhen të gjitha zotimet edhe për projektet për të cilat kanë qenë të zotuar më parë.

Vlersimet e Auditorit

Mjetet te cilat shfrytëzohen nga AKP(AKM) janë mjete te BKK-së , dhe meqenëse Kompleksi Trepça është Ndërmarrje nën administrimin e AKP(AKM), per menaxhimin e tyre duhet te veproj në pajtim me ligjet dhe rregullat e caktuar sa i përket procedurave të zotimit te mjeteve. Prandaj komenti i juaj nuk pranohet.

7.3. Mungesa e sigurimit te ekzekutimit

Me rastin e ekzaminimit te këtyre lendeve kemi vërejtur se kane munguar sigurimet e ekzekutimit ne këto kontrata:

- Furnizimi me vajra dhe yndyra për minierën me flotacion Trepça në Stan Tërg me numër identifikimi: ST-016/2008 ne vlere prej 26,553 €.
- Furnizimi me pompë për Minierën me flotacion Trepça në Stan Tërg me numër identifikimi: ST-018/2008 ne vlere 97,678 €.
- Furnizimi me eksploziv për Minierën e Stan Tërg-Artan me numër identifikimi: ST+KHA-045/2008 , ne vlere 71,000 €.

Konkluzion

Mungesa e sigurimit të ekzekutimit mund te ndikon qe në rast të thyerjes se kontratës nga operatori ekonomik, ti shkaktohet dëme autoritetit kontraktues.

Rekomandim 8

Entiteti duhet te kërkoj nga operatori ekonomik te cilit i është dhëne kontrata te depozitoj sigurinë e ekzekutimit si parakusht për nënshkrimin e kontratës duke respektuar Nenin 60 të LPP-së 2003/17.

Komenti i Kompleksit Trepça

Mungesa e sigurimit të ekzekutimit

Disa prokurime nga ana e “Trepçës” planifikohen të financohen nga burimet vetjake.Për shkak

OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL • Rr. Gazmend Zaimi # 59, PRISTINË 10 000

PHONE: +381 (0) 38 2535 162/244/119 • FAX: +381 (0) 38 2535 122

të zvogëlimit të hyrave të cilat gjenerohen nga shitja e koncentratit e ndikuar nga rënja e çmimeve të metaleve disa furnizime të kryera më heret nuk janë paguar në mungesë të mjeteve.

Me qenë se disa furnizues kanë lidhur kontrata tjera por që më parë kanë pasur kontrata të papaguara nga ana e “Trepçës” ka qenë ngarkesë shtesë për operatorët ekonomik që të ju kërkohet sigurimi i ekzekutimit (rastet me OE “Bibaj” ST-016/2008, 26.553 €-për vajra dhe “Ex-Projekt” –ST+KHA-045/2008 në vlerë 71.000 -për eksploziv), kurse për lëndën furnizim me pompë ST-018/2008 në vlerë 97,678 € siguria e ekzekutimit është në lëndë.

Vlerësimi i Auditorit

Gjate punës në teren nuk na është ofruar siguria ekzekutimit lendet në piken 7.3 ,mirëpo nga komentet e juaja na është ofruar se ekziston sigurimi i ekzekutimit për lenden, Furnizimi me pompë për Minierën me flotacion Trepça në Stan Tërg me numër identifikimi: ST-018/2008 ne vlere 97,678 €, ku siguria e ekzekutimit vlen për periudhën 05.12-20.01.2009 ne vlere 9,769 €, ndërsa kontrata është lidhur me datën 07.05.2008.

Prandaj komenti i juaj nuk pranohet, e gjetura mbetet.

7.4. Furnizime jashtë Kontratës

Gjate ekzaminimit te lendes Furnizimi me vajra dhe yndyra për minierën me flotacion Trepça në Stan Tërg më numër identifikimi: ST-016/2008ne vlere prej 26,553 €, është vërejtur se furnizimi me vajra dhe yndyra ka tejkaloar vlerën e kontratës për 1,161 €.

Konkluzioni

Për furnizimet shtese qe janë bere jashtë kontratës mund te paraqiten probleme gjate realizimit te pagesave, te cilat njiherit mund te jene edhe ngarkese për buxhetin e Entitetit.

Rekomandim 9

Rekomandojmë entitetin qe me rastin e furnizimit te mos tejkaloj shumen e përcaktuar ne kontrate,dhe të jenë ne përputhje me shumat e kontraktuara.

Komenti i Kompleksit Trepça

Furnizime jashtë kontrates

Lidhur me tejkalinimin e kontrates fillestare prej 1,161 € (Kontrata për furnizim me vajra ST-016/2008 në vlerë prej 26.553),si zyrë e prokurimit mund të japim sqarimin si vijon:

1. kjo mund të rrjedhë nga se në sasi të që ne i kemi përcaktuar në dokumentin e tenderit ne kemi caktuar në bazë të njohurive tona sasinë për një lloj të vajit mirëpo ambalazhimi i prodhuesit në disa artikuj ka diktuar që sasia të jetë më e madhe,
2. kjo mund të shihet nga vlere 1.161 € e cila në raport me kontraten është vetëm 4.37 %,
3. çmimet janë të njëjta me ato të kontraktuara dhe

4. kjo nuk është bërë me aprovimin e zyrës së prokurimit.

Vlerësimet e Auditorit

Furnizimete me vlera me te larta se kontrata praqesin probleme ne realizimin e pagesave si dhe krijojne obligime të pa parashikuara .

Prandaj komenti i juaj nuk paraqet arsye bindese per ndryshimin e te gjetures , pra e gjetura mbetet.

7.5. Diferenca në mes të specifikacionit teknik ne dosjen tenderit dhe faturës

Gjatë ekzaminimit të lendes Furnizimi me eksploziv për minierën e Stan Tërg-Artan me numër identifikimi: ST+KHA-045/2008, kemi identifikuar ekzistimin e pozicioneve ne faturë te cilat nuk kane qen ne specifikacionin teknik te dosjes se tenderit..

Konkluzioni

Pozicionet ne fature jashtë specifikacionit teknik te dosjes se tenderit mund te shkaktojë shpenzime te papritura për entitetin, sidomos për pjesët te cilat nuk janë paraparë në specifikacionin e ofertës dhe kontrate, andaj mund te dëmtojë buxhetin e Entitetit

Rekomandim 10

Rekomandojmë entitetin qe gjate furnizimit me mallra, shërbime, apo investime kapitale te rishikojnë specifikacionet teknike te dosjes se tenderit ne mënyre qe te mos ketë faturime te artikujve te cilët nuk janë parapare ne specifikacionin teknik te ofertës fituese. Po ashtu Departamenti i prokurimit ne një afat sa me te shkurtër kohore te filloj me procedura te reja te prokurimit ne mënyre qe specifikacioni teknik ne dosjen e tenderit te jete me gjithëpërfshirës .

Komenti i Kompleksit Trepça

Diferenca në mes specifikacionit teknik në dosjen e tenderit dhe faturës

Në këtë pikë auditorët kanë të drejtë por Zyra e Prokurimit nuk ka qenë e implikuar.Kapsolla 700 copë x0.70=490,00 € janë porositur nga përgjegjësit në Minierat me Flotacion në Kizhnicë të cilët nuk kanë qenë të paraparë me dokumentin e tenderit për furnizim me eksploziv.

Porositja është bë për shkak të nevojës së intervenimit urgjent në oxhakun e xehes në mes të horizontit të V dhe të VI

Vlerësimi i Auditorit

Entiteti është pajtuar me konstatimin e auditorit, e gjetura mbetet.

7.6. Furnizimi me Makine ngarkuese për Minierën nëntokësore (underground LHD)

Gjate ekzaminimit të lendes Furnizimi me Makine ngarkuese për Minierën nëntokësore (underground LHD) me numër identifikimi: ST-015/08 ne vlere 286,350 €, kemi konstatuar se kontraktuesi (operatori ekonomik) nuk i u ka përmbajtur marrëveshjeve kontraktuale .

Ne kontrate është ofruar çmimi ne vlere prej 286,350 €, prej tyre 5% janë parapare për pjese rezerve duke përfshire:

- Vizita në panairin botëror të mineraleve në Las Vegas për dy persona,
- Vizita studimore ne Suedi për dy persona ,
- Si dhe një liste e pjesëve të domosdoshme rezerve qe Trepça përpilon ne vlere 2% te vlerës se kontratës

Prej këtyre kushteve te dhëna ne kontrate, asnjëra prej tyre nuk është përmbushur. Po ashtu kjo makine e ngarkim – shkarkimit ne ministren nëntokësore cila e ashte blere ne vlere prej 286.350€ ende nuk është vene ne përdorim.

Konkluzion

Mosrespektimi i kushteve dhe kritereve te kontratës ndikon qe te dëmtohet buxheti i entitetit si dhe ndikon mos realizimin e performances ne entitet.

Rekomandim 11

Rekomandojmë entitetin qe të kërkoj nga operatorët ekonomik përmbahet kushteve të kontratës ne baze të cilës është shpërblyer operatori ekonomik, si dhe të veje pajisjet në përdorim sa ma shpejt te jete e mundur.

Komenti i Kompleksit Trepça

Furnizimi me makinë ngarkuese për miniera nëntokësore (underground LHD) Sipas kontratës (kopja në shtojcë) janë parapa në vlerë prej 5% të kontrates pjesë rezervë dhe trajnim njëjavor i stafit në minierë pas arritjes së makinës dhe asnjë shkuarje në Las Vegas apo diku tjetër.Pjesa e kontratës për pjesë rezervë nuk është realizuar sipas dinamikës për shkak të mungesës së specifikimit –katalogut të pjesëve rezervë si dhe grevës nga ana e punëtorëve të minierës së Stantërgut kur ka qenë eksperti nga “Atlas-Copco” i cili edhe ka pasur për obligim me na ndihmue për specifikimin e pjesëve më të domosdoshme. Makina ngarkuese është lëshuar me vonesë në funksion për shkak të problemeve në sigurimin e morsetave të atestuara.. Morstat janë sigurua dhe makina ngarkuese është në funksion në horizontin e X qysh para një muaji.

Vlerësimet e Auditorit

Marrëveshjet kontraktuale nuk janë realizuar ne vlere pre 5% te kontratës për pjese rezervë si dhe trajnimi në Las Vegas apo diku tjetër.

Nga ekzaminimet fizike në teren makina ngarkues nuk ka qene ne funksion, ndërsa komenti i juaj mbetet te vërtetohet në auditimet e ardhshme_.

8. MENAXHIMI I PASURISË

8.1. MJETET THEMELORE DHE INVENTARI

Ne baze te Pasqyrës se bilancit te gjendjes vlera e pasurive ne kompleksin Trepça është 5,132,251€, ndërsa regjistri i pasurisë tregon vlerën e pasurisë prej 3,032,782 €, diferenca prej 2.099.469 del nga mungesa e regjistrimit te mjeteve themelore dhe inventarit ne pjesën Veriore (Trepça veriore).

Të gjeturat

- Nuk ka zyrtar te pasurisë i cili merret me menaxhimin e pasurisë.
- Kemi konstatuar se sa i përket evidencës se pasurive të dhënat nuk janë te plota.
- Gjate auditimit në njësinë e Stan Tërg-ut, respektivisht gjate ekzaminimit fizik te pjesëve rezeve te makinerive dhe pajisjeve, kemi hasur ne pjese te makinerive dhe pajisjeve (te trashëguara) te cilat nuk kane qene te evidentuara në regjistrat e pasurisë.
- Pasurit në pjesën veriore nuk janë përfshire në regjistrat e pasurisë.

Konkluzioni

Për shkak të mungesës së një regjistri te saktë të pasurive, Kompleksi Trepça – Stan Tërg, nuk është në gjendje të kontrollojë dhe të menaxhoj si duhet pasuritë e saj, gjë që rrit rrezikun për keqpërdorim. Mos regjistrimi i vlerës së pasurive rezulton në raportimin e të dhënave jo të plota dhe te sakta .

Rekomandimi 12

- I rekomandojmë menaxhmentit te Trepçës qe te caktoj një person adekuat i cili do te merret me menaxhimin e pasurisë, qe te vendos kontrole mbi menaxhimin e pasurit.
- Entiteti të krijoj një regjistër te plote te pasurisë, si dhe te evidentohen edhe pasurit te cilat janë trashëguar nga periudha e kaluar.

Komenti i Kompleksit Trepça

Lidhur me piken 2 dhe 3 te gjetjeve mbi menaxhimin e pasurisë, se “evidencat e pasurive te dhëna nuk janë te plota” (pika 2) dhe se “gjate ekzaminimit fizik te pjesëve rezerve te makinerive dhe pajisjeve, kemi hasur ne pjese te makinerive dhe pajisjeve (te trashëguara) te cilat nuk kanë qene te evidentuara ne regjistrat e pasurisë” kemi vërejtjet sa vijon:

Ne shënimet e prezantuara për raportin financiar janë përfshirë vetëm pasuritë te cilat janë blere pas luftës dhe për te cilat dihet kostoja e tyre e blerjes, ndërkaq qe për pasuritë e trashëguara (te cilat janë te shumta) për shkak te pamundësisë ligjore te valorizimit te tyre kemi bere evidentimin e tyre fizik nga ana e secilës njësi te Trepçës-Jug dhe regjistrat e tille ekzistojnë. Ndërsa lidhur me regjistrimin e pasurive te pjesës Veriore te Trepçës, fatkeqësisht aty ne nuk kemi kurrefar mundësie te ndikojmë sikurse edhe tek çështjet tjera qe lidhen me pjesën Veriore

Vlerësimet e Auditorit

Entiteti duhet të këtë edhe të dhënat në sasi ,respektivisht duhet te evidentohen te gjitha pasurit ne pronësi te kompleksit , prandaj e gjetura mbetet.

9. MENAXHIMI I AUTOMJETEVE

Nga auditivi i automjeteve kemi vërejtur se Njësia Stan-Tërg nuk disponon me regjistra të automjeteve, ekziston vetëm një regjistër në Drejtorin e financave në Kompleksin Trepça. Ky regjistër përmban tri Automjete: kamion "veko" dizel .tip zastava NEW turbo rival 35-10, Mini bus Upto 15Pax KMFjD3 Iu479665, Toyota 4RUNNER KNZ185-0058867 Un21173

Të gjeturat

- Sa i përket menaxhimit të automjete Kompleksi Trepça –Stan Tërg nuk ka politika si dhe procedura të cilat e caktojnë mënyrën e shfrytëzimit të automjeteve.
- Nuk mbahen dosjet e veçanta për secilin automjet të cilat duhet të përmbajnë të gjithë dokumentacionin e blerjes, shpenzimet e riparimit, kontrollit, mënyrës së përdorimit etj.
- Nuk mbahen evidenca mbi qëllimin e shfrytëzimit të automjeteve, destinimin, kilometrat e kaluara, kthimi i automjetet në entitet etj.

Konkluzioni

Mungesa e një kontrolli mbi automjetet do të ndikojë që automjetet e entitetit të shfrytëzohen në mënyrë jo racionale si dhe për qëllime private.

Rekomandimi 13

- Rekomandojmë Entitetin që të hartoj politika si dhe procedura të cilat e përcaktojnë mënyrën e shfrytëzimit të automjeteve.
- Te mbaje dosje të veçante për secilin automjet të cila duhet të përmbaje faturën e blerjes së automjetit, sigurimet, servisimit dhe riparimet, si dhe evidenca të ndryshme për automjetet.
- Te mbaj të dhëna sa i përket qëllimit të shfrytëzimit të automjeteve, kilometrave të kaluara si dhe kohën e kthimit në entitet.